



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI PORTUAL DURRËS

PROCESVERBAL – Tipi i kontratës – Mall
(Procedurë e Hapur e Thjeshtuar - Mall)

PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE PËR KUALIFIKIM

OBJEKTI I PROCEDURËS: “Blerje pjesë këmbimi për Reachstacker dhe Spreader te Vincave dhe Reachstacker”

VLERA E FONDIT LIMIT: 6.500.000 (gjashtë milion e pesëqind mijë) lekë pa tvsh

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):

Pjesë këmbimi për motorë 34312000-7

Afati i lëvrimit do jetë **12 (dymbëdhjetë) muaj** nga data e nënshkrimit të marrëveshjes kuadër.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor Autoriteti Portual Durrës ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

- a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9
- b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 4;

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, i ndryshuar, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” të ndryshuar.

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

Kjo pikë përmbushet sipas pikës a) të Kriterëve të Përgjithshme (sipas shtojcës 8).

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP-së i ndryshuar, nenin 40, pika 5, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore të realizuar për tre viteve e fundit financiare (2022-2023-2024), ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 40% e vlerës së fondit limit. Kriteri konsiderohet i përmbushuar nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, pra 40% e vlerës së fondit limit, në të paktën 1 (një) vit të periudhës së kërkuar të viteve financiare.

Argumentimi:

Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, pika 2/c e 55, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", të ndryshuar. Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrit të Financave nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, si dhe kërkesave të ligjit Nr. 25/2018 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare". Vlera e xhiros së kërkuar është vendosur duke pasur në konsideratë objektin e kontratës, natyrën dhe volumin e saj. Vlera e xhiros është vendosur që t'i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kapacitetet e nevojshme, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.1 Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 20 % nga vlera e përllogaritur e fondit të limit të kësaj kontrate.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- Si dëshmi për përvojën e mëparshme kërkohen **vërtetime** të lëshuara nga një ent publik ose **fatura tatimore** të shitjes, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të furnizimit e realizuara. Faturat të jenë të deklaruara në organet tatimore.
- Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm **fatura tatimore** të shitjes, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të furnizimit e realizuara. Faturat të jenë të deklaruara në organet tatimore.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik", si dhe në nenin 40, pika 4 e 55, pika 4/b, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", të ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën me sukses, prandaj është kërkuar që kontratat e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 20 % të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

Përvoja e mëparshme është një element shumë i domosdoshëm që garanton autoritetin kontraktor se operatorët ekonomikë mbi bazën e vlerës së kontratave të ngjashme zotërojnë kapacitete për të zbatuar kontratën me sukses sipas një standarti të përshtatshëm cilësie. Në mbështetje të nenit 88 pika 1 e VKM 285/2021, parashikon se "Oferta mund të paraqitet nga

një bashkim operatorësh ekonomikë, sipas përcaktimit të pikave 2 dhe 3, të nenit 14, të LPP-së, ku njëri prej të cilëve i përfaqëson të tjerët gjatë procedurës dhe, në rast përzgjedhjeje, edhe gjatë zbatimit të kontratës. Në ofertë duhet të përcaktohet pjesa e shërbimit, punës ose furnizimit, që do të kryejë secili nga anëtarët e këtij bashkimi nëpërmjet një kontrate bashkëpunimi të hartuar ndërmjet palëve.

Kërkesa të tjera të veçanta për kualifikim

2.3.2 Operatori ekonomik duhet të paraqesë ofertën teknike, për disa nga mallrat objekt prokurimi sipas listes në formatin “Oferte Teknike”, në formën e një table sipas modelit të mëposhtëm, e cila duhet të plotësohet në mënyrë rigoroze. Oferta teknike duhet të përmbajë të dhënat si më poshtë;

- Emri i kompanisë prodhuese
- Emërtimi i Katalogut të prodhuesit ose i skedës teknike
- Numri i faqes në katalog ose në skedën teknike ku ndodhet artikulli
- Numri (kodi) identifikues i artikullit të ofruar, i shënuar me një shenjë dalluese.

Të dhënat e deklaruara në ofertën teknike duhet të korespondojnë me të dhënat për artikujt në katalogët/skedat teknike të dorëzuara. Moskorespondimi i këtyre të dhënave do të sjellë pavlefshmëri të ofertës.

Argumentim: Ky kriter është menduar për ti dhënë sigurinë AK që OE ofertues do të paraqesë mallra, të cilët përmbushin kërkesat e specifikimeve teknike dhe janë në përputhje me to. Kriteri i kerkuar në lidhje me katalogun e prodhuesit/prodhuesve, është vendosur në përputhje me piken 6, të Nenit 40, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” të ndryshuar.

2.3.3 Në mënyrë që të krahasohet pajtueshmëria me specifikimet teknike dhe standardet e kerkuara, operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë Katalogun/et ose fragmente të katalogut/eve të prodhuesit/ve për listën e mallrave në ofertën teknike, në të cilët të tregohen dhe të specifikohen qartë materialet që do të ofrohen.

Shenim: Fragmentet e katalogut/ve duhet të tregojnë lehtësisht dhe qartë që janë pjesë katalogu, si dhe cilit katalog dhe cilit prodhues i perkasin.

Argumentim: Ky kriter është menduar për ti dhënë sigurinë AK që OE ofertues do të paraqesë mallra, të cilët përmbushin kërkesat e specifikimeve teknike dhe janë në përputhje me to. Kriteri i kerkuar në lidhje me katalogun e prodhuesit/prodhuesve, është vendosur në përputhje me piken 6/b, të Nenit 40, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” të ndryshuar.

2.3.4 Autorizim prodhuesi/distributor

Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë autorizim prodhuesi ose distributori zyrtar për mallrat objekt prokurimi kjo e vertetuar nëpërmjet dokumentave origjinal si përfaqësues i kompanisë prodhuese për mallin/mallrat të zërit në listë:

- Kabull Elektrik super felx 44 x 2.5

Ne rast paraqitje Autorizimi Distributori, OE duhet te paraqese ne leter angazhim ose Akt marreveshje midis prodhuesit dhe distributorit e vlefshme midis tyre, mbi të drejtat e furnizimit me llojin e mallit të ofruar ne Republiken e Shqiperise.

Argumentim: Autorizimi i prodhuesit ose distributorit të autorizuar është një dokument i rëndësishëm, pasi përveç se tregon origjinën e mallrave që kërkohen në procedurë, na garanton se ofertuesi është i autorizuar për ofrimin tek AK të këtyre mallrave. Kjo garanci lidhet njëkohësisht edhe me treguesit cilësorë të mallrave që kërkohen të blihen e që janë prodhuar në përputhje me standardet . Ky kriter është në përpjestim me natyrën dhe përmasat e kontratës dhe lidhet drejtpërdrejtë me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë e OE ofertues për aftësitë teknike. Kjo kërkesë i shërben autoritetit kontraktor për njohjen e mundësisë së OE-se për përmbushjen me sukses të kontratës. Ky kriter është në përputhje me nenin 77, pika 4, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe pikën 6, të nenit 40, të V.K.M-së Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

2.3.5 Mostrat

Në mënyrë që të krahasohet pajtueshmeria me specifikimet teknike dhe standartet e kerkuara, operatori ekonomik duhet të paraqesë mostra:

- | | |
|--|--------|
| • Pakete Komandimi 2420.0110.0004/Ekuivalent | 1 cope |
| • Kuzhinet GE 60 ES-2RS/Ekuivalent | 1 cope |
| • Tensionues Rripi 8149855/Ekuivalent | 1 cope |
| • Rrip dinamo 8PK1480TM/Ekuivalent | 1 cope |
| • Proximity switch EGT30X10AP024/Ekuivalent | 1 cope |
| • Kabull Elektrik super flex 44x2.5 | 1 ml |

Ky kriter i shërben Autoritetit Kontraktor për rëndësinë e mallrave dhe përshtatshmerinë që duhet të kenë në objektet ekzistuese ndaj është e nevojshme sjellja e mostrave.

Shënim: Ky kriter përbën kusht skualifikimi në rast se mostrat e dorëzuara nuk janë sipas specifikimeve teknike të kërkuara. Mosparaqitja mostrave përbën kusht për skualifikim.

Argumentim: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në piken 6 gërma a, të nenit 40 të VKM nr 285 date 19.05.2021 “Per Miratimin e Rregullave te Prokurimit Publik”, ne te cilen eshte e percaktuar se: 6. Autoriteti/enti kontraktor mund t’u kërkojë operatorëve ekonomikë të dorëzojnë dëshmi, që tregojnë se ata i plotësojnë kërkesat minimale, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, si: a) mostra të mallit, kur e gjykon se kjo ka rëndësi për vlerësimin e ofertës teknike. Mostrat duhet të trajtohen si informacion konfidencial tregtar dhe duhet të jenë në kontroll të autoritetit/entit kontraktor. Në rastin e procedurave të zhvilluara me mjete elektronike, autoriteti ose enti kontraktor përcakton qartë procedurën për dorëzimin e mostrave, duke garantuar aksesin e çdo operatori të interesuar si dhe konfidencialitetin për pjesëmarrjen në proces.

Argumentimi i marrëveshjes kuadër:

1. Marrëveshja kuadër do të lidhet me një operator ekonomik pasi janë të përcaktuara të gjitha kushtet kryesore të tilla si: artikujt, specifikimet e sakta teknike, afatet e lëvrimit, si dhe sasitë që priten të furnizohen.
2. Nga përvoja e prokurimit të artikujve (objekt i kësaj procedure) në vite, çmimet e tregut kanë rezultuar të jenë të qëndrueshëm dhe nuk ndryshojnë.
3. Në rast se kjo marrëveshje do të lidhej me disa OE do të shkaktonte kosto shtesë dhe vështirësi autoritetit kontraktor si p.sh mospërputhje të artikujve të dhënë në bazë të rendit, pjesë të tyre të përbashkëta.

Afati i marrëveshjes kuadër do të jetë 12 (dymbëdhjetë) muaj nga nënshkrimi i marrëveshjes kuadër.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.

Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

KUSHTET PER TU ZBATUAR NE PRANIM.

A. Në fazën e pranimit, janë të detyruar të paraqesin;

Dokumente origjinale ose të njëvlefshme, të deklaruara në institucionet tona zyrtare, me anë të të cilave të demonstron produktet e ofruara

VERIFIKIMI DOKUMENTEVE TE DOREZUARA

AUTORITETI KONTRATOR, rezervon të drejtën të kryejë, të gjitha verifikimet që i konsideron të nevojshme, për të garantuar mbi vlefshmerinë e dokumenteve të kërkuara.

ARGUMENTIMI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE

Specifikimet teknike janë hartuar duke marrë në konsideratë nevojat e Autoritetit Kontraktor, për mallrat objekt procedure prokurimi, duke përlogaritur sasitë e nevojshme, karakteristikat e duhura dhe standardet e duhura kombëtare dhe ndërkombëtare, në përputhje me parashikimet e nenit 4 ,pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, i ndryshuar, si dhe nenit 40, pika 1 dhe 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” të ndryshuar.

KOMISIONI I PERCAKTIMIT TE SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE PERLLOGARITJES SE VLERES SE FONDIT LIMIT